

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 1175/12 (Gjykata Themelore e Prishtinës, P 371/10)

Data: 10 shkurt 2014

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarës së EULEX-it Annemarie Meister, kryetare e kolegjit dhe gjyqtare raportuese, gjyqtarit të EULEX-it Philip Kanning dhe gjyqtarit Driton Muharremi si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e Andres Parmas, zyrtar ligjor i EULEX-it, e cila vepron në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën penale kundër të akuzuarit

F.G., Data e lindjes... shqiptar i Kosovës, me shtetësi kosovare, i martuar, i arrestuar më 13 korrik 2010, në paraburgim prej datës 14 korrik 2010 deri më 19 gusht 2010 dhe në paraburgim prej datës 19 gusht 2010;

I akuzuar dhe i shpallur fajtor për veprën penale të *Krime lufte kundër popullatës civile* sipas neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Gazeta Zyrtare RSFJ nr. 44/1976, tash e tutje në tekst: KP RSFJ)

I dënuar me 18 vjet burgim;

Duke vepruar sipas ankesës së avokatit mbrojtës T.R. e ushtruar në emër të të akuzuarit F.G. kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës nr. P 371/2010 të datës 23 nëntor 2011 (tash e tutje në tekst: aktgjykimi i kundërshtuar);

Pas marrjes parasysh të mendimit të prokurorit të apelit të shtetit të Kosovës nr. PPA 515/12 i parashtruar në Gjykatën e Apelit më 11 janar 2013;

Pas mbajtjes së seancës publike më 10 shkurt 2014 në praninë e të akuzuarit F.G., avokatit të tij mbrojtës T.R. dhe prokurorit të apelit të shtetit Judit Eva Tatraj;

Pas këshillimit dhe votimit më 10 shkurt 2014;

Në pajtueshmëri me nenet 420 e më pas të Kodit të procedurës penale të Kosovës (tash e tutje në tekst: KPPK)

lëshon këtë

AKTGJYKIM

1. **Pjesërisht pranohet ankesa e avokatit mbrojtës.**
2. **Ndryshohet aktgjykimi i kundërshtuar i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës nr. P 371/10 i datës 23 nëntor 2011 dhe F.G. dënohet me katërmbëdhjetë (14) vjet burgim.**

ARSYETIMI

I Historia e lëndës

1. Më 5 nëntor 2010 është ngritur aktakuza kundër **F.G.** dhe H.R. **F.G.** u akuzua për veprën penale të *Krime lufte kundër popullatës civile* sipas neneve 22 dhe 142 të KP RSFJ (në atë kohë e dënueshme sipas nenit 23 dhe 120 të Kodit të përkohshëm penale të Kosovës – KPK). Aktakuza është konfirmuar me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të datës 21 dhjetor 2010. Shqyrtimi gjyqësor ishte mbajtur në mes të 15 mars 2011 dhe 22 nëntor 2011. Aktgjykimi është shpallur më 23 nëntor 2011.
2. **F.G.** është shpallur fajtor për veprën penale të *Krime lufte kundër popullatës civile* sipas neneve 22 dhe 142 të KP RSFJ, sepse më 15 qershor rreth orës 21.30 gjatë konfliktit të armatosur të brendshëm në Kosovë, në cilësinë e anëtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe në bashkëkryerje me N.B. vrau në shtëpi të vet personin civil S.G.
3. Gjykata e shkallës së parë vërtetoi se vrasja e S.G. ishte pikërisht krim i luftës sepse kishte ndodhur gjatë konfliktit të armatosur, ishte kryer nga një person i cili ka marrë pjesë në mënyrë aktive në konflikt, vepra penale ishte e lidhur me konfliktin dhe ishte në shkelje të dy normave të ligjit humanitar të asaj kohe, normës vendore dhe asaj ndërkombëtarë. Lidhur me ekzistimin e konfliktit të armatosur trupi gjykues konsideron se sipas ligjit humanitar ndërkombëtar një konflikt i armatosur jo ndërkombëtar fillon me inicimin e një konflikti dhe zgjat derisa të arrihet një zgjidhje paqësore pavarësisht faktit nëse luftimi përkatës zhvillohet. Gjykata e Qarkut vërtetoi se në Kosovë kishte ndodhur një konflikt i brendshëm i armatosur më 15 qershor 1999, sepse në kohën e kryerjes së veprës penale për të cilën **F.G.** akuzohet, ende nuk ishte arritur një marrëveshje paqësore në mes të palëve të përfshira d.m.th, Serbisë, UÇK-së dhe NATO-s. Të gjitha ofensivat ishin duke u zhvilluar, forcat serbe ende ishin të pranishme në Kosovë, e edhe çarmatosja dhe shpërbërja e UÇK-së ende nuk kishte filluar. Trupi gjykues arriti një konkluzion të tillë bazuar në një analizë të

plotë të dokumenteve qeveritare dhe jo qeveritare si edhe në praktikën ndërkombëtare të gjykatës që ka të bëjë me konfliktin e armatosur në Kosovë.

4. Gjykata po ashtu vërtetoi se **F.G.** ishte pjesëmarrës aktiv dhe se vrasja e S.G. ishte drejtpërsëdrejti e lidhur me konfliktin e armatosur. S. G., duke qenë anëtar i UÇK-së dhe në pjesëmarrje aktive në konfliktin që ishte duke u zhvilluar, qëlloi dhe vrau personin civil S.G., për shkak të deklaramit se ai ishte bashkëpunëtor serb. Njëherazi gjykata vërtetoi se përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, një sjellje e tillë shkeli edhe ligjin vendor dhe rregullat e ligjit ndërkombëtar që ishin në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur.
5. Gjykata e shkallës së parë gjerësisht shoshiti besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues N.B. dhe nxori konkluzionin se pavarësisht nga fakti se N.B. padysim kishte një armiqësi ndaj të pandehurit dhe u përpoq t'i bënte shantazh për të mos ardhur me akuza të cilat janë objekt i kësaj lënde penale, deklaratat e tij janë ende të besueshme. Trupi gjykues theksoi se deklaratat e N.B. janë vërtetuar me prova të tjera; me dhënien e deklaratave ai e ekspozoi veten si bashkë i pandehur; ai dha deklaratat të cilat e inkriminojnë vet atë dhe **F.G.** para se ai tashmë të ishte dëshmitar bashkëpunues.
6. Bazuar në deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues N.B. dhe deklaratat e dëshmitarëve të tjerë, gjykata e shkallës së parë vërtetoi se i pandehuri **F.G.** në realitet qëllloi dhe vrau viktimën S. G. rreth orës 21.30 më 15 qershor 1999.
7. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë specifike refuzoi qasjen e propozuar nga avokati mbrojtës se deklaratat e N.B. të dhëna në cilësinë e të pandehurit janë të papranueshme si prova. Ndërrimi i statusit nga ai i dëshmitarit në të dyshuar dhe nga i dyshuari në dëshmitar bashkëpunues nuk e ndryshon vlerën provuese të deklaratave të dhëna për aq sa deklaratat janë mbledhur duke aplikuar normat procedurale përkatëse.
8. Gjykata e Qarkut po ashtu i ka kushtuar vëmendje të veçantë faktit se dënimi nuk duhet gjithsesi të mbështetet vetëm në deklaratat e një dëshmitari bashkëpunues, duke analizuar deklaratat e disa dëshmitarëve të tjerë të cilat plotësisht e kanë vërtetuar deklaratën e dhënë nga N.B..
9. Në lidhje me alibinë e dhënë nga mbrojtja, Gjykata e Qarkut e konsideroi këtë të jetë jo bindëse. I pandehuri ka sjellë alibinë vetëm në një fazë të mëvonshme të procedurës, jo në fazën e procedurës paraprake, gjë e cila është e palogjikshme dhe tanimë ngreh dyshime të vërtetësisë së vet alibisë. Personat të cilat kanë dëshmuar në emër të **F.G.**, se ai kishte festuar përfundimin e konfliktit me Serbinë në ditën e vrasjes së S.G., nuk janë të besueshme sepse gjykata nuk e beson pohimin e tyre universal për të kujtuar hollësitat e asaj ngjarje të veçantë madje edhe pas 12 vjetësh. Trupi gjykues dyshon se deklaratat e këtyre

dëshmitarëve janë të ndikuara dhe fotografia e paraqitur si provë për këtë ngjarje është falsifikuar. Megjithatë gjykata po ashtu ka konsideruar se madje edhe në rast se deklaratat në lidhje me festimin e përfundimit të konfliktit do të ishin të vërteta, kjo nuk do të përjashtonte mundësinë që **F.G.** mund të ketë qenë në vendin e krimit në kohën kur vrasja e **S.G.** ndodhi.

II Parashtrësat e palëve

Ankesa

10. Më 16 maj 2012 avokati mbrojtës i të pandehurit **F.G.** ushtroi ankesë duke propozuar që i mbrojturi i tij ose të lirohet ose lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

Shkeljet e normave procedurale

11. Ankesa argumenton se aktgjykimi i kundërshtuar është nxjerr me shkelje esenciale të procedurës penale. Aktgjykimi i nënshkruar dhe i arsyetuar i është dorëzuar avokatit mbrojtës vetëm pas më shumë se pesë muaj nga shpallja publike e tij.

12. Dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe në kundërshtim me veten e edhe në kundërshtim me arsyetimin e tij.

13. Aktgjykimi nuk përmban arsyetim mbi faktet vendimtare dhe arsyetimi ekzistues është i paqartë dhe në kundërshtim me veten. Avokati mbrojtës thekson se trupi gjykues gaboi kur nuk dëgjoi shumë dëshmitarë të propozuar nga mbrojtja dhe nuk i administroi provat materiale, thjesht i injoroi kërkesat e mbrojtjes në këtë aspekt. Ankuesi ka vënë në pah se trupi gjykues e la të pa vënë re fjalën e tij përfundimtare ku çdo pohim i vetëm i paraqitur në aktakuzë është prishur. Gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar në mënyrë korrekte provat kundërrthënëse.

14. Trupi gjykues në kundërshtim me nenin 371 (1) të KPPK-së dëgjoi të pandehurin **F.G.** para se të dëgjonte dëshmitarin e mbrojtjes, **B.D.** Në kundërshtim me nenin 371 (3) të KPPK-së i pandehuri **H.R.** nuk është larguar nga sallë e gjykatës gjatë marrjes në pyetje të të pandehurit **F.G.**

15. Aktgjykimi është bazuar vetëm në deklaratën e dëshmitarit jo të besueshëm bashkëpunues **N.B.**, që është në shkelje të nenit 157 (4) të KPPK-së. Pala ankuese po ashtu thekson se deklaratat e **N.B.** të dhëna në cilësinë e të pandehurit, janë të papranueshme sepse ndryshe nga dëshmitari, i pandehuri nuk është nën asnjë obligim që të thotë të vërtetën ose të përgjigjet në pyetjet e bëra ndaj tij lidhur me rrethanat e lëndës në përgjithësi.

16. Duke shkelur barazinë e palëve dhe nenin 302 të KPPK, urdhëresa me të cilën N.B. shpallet dëshmitar bashkëpunues nuk i është dorëzuar të pandehurit. Kështu i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës në mënyrë efektive u mohuan nga e drejta për të kundërshtuar këtë urdhëresë.
17. Aktakuza u konfirmua në kundërshtim me nenin 313 (2) të KPPK-së, sepse në seancën e datës 22 tetor 2010 kur është lëshuar aktvendimi mbi konfirmimin e aktakuzës, palët të cilët patjetër është dashur të jenë prezentë në seancë në realitet nuk ishin të pranishme dhe ato madje as nuk ishin të njoftuar për këtë seancë.
18. Shkelje të rënda të procedurës penale janë bërë tanimë në dëm të të akuzuarit në fazën para - hetimore dhe hetimore sepse bashkë i pandehuri H.R. ishte ftuar në polici si dëshmitar por gjatë intervistës policia duke përdorur shtrëngimin dhe kërcënimet e ndryshoi statusin e tij nga dëshmitar në të dyshuar. E njëjta ndodhi gjatë fazës hetimore kur prokurori përsëri përdori kërcënimet dhe shtrëngimin kundër H.R. dhe ndryshoi statusin e tij nga dëshmitar në të dyshuar me qëllim që ta largojë atë të jap deklaratën e dëshmitarit në të mirë të **F.G.**
19. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues shkeli procedurën penale duke lejuar prokurorin të bëjë pyetje sugjестive dhe udhëheqëse ndaj dëshmitarit bashkëpunues dhe duke i bërë vazhdimisht pyetje të njëjta derisa të merrej përgjigja e “drejtë”, duke injoruar kundërshtimet e avokatit mbrojtës. Edhe prokurori ka ndërhyrë në marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes, duke e çorientuar avokatin mbrojtës dhe duke u përpjekur të shmangë ushtrimin e mbrojtjes. Si shkelje tjetër substanciale e procedurës penale, trupi gjykues e lejoi prokurorin të shfrytëzojë si provë deklaratat e disa dëshmitarëve të mbrojtjes të cilët ishin marrë në pyetje nga prokuroria në kohën kur ishte duke u zhvilluar shqyrtimi gjyqësor. Edhe pse avokati mbrojtës kishte propozuar për t'i shpallur të papranueshme deklaratat e tilla, trupi gjykues madje as nuk ka marrë një vendim në këtë aspekt. Ankuesi është i mendimit se pas përfundimit të hetimeve, prokurori nuk ishte i autorizuar që të ndërmarrë hapa të ri hetimor *p.sh.* për të marrë në pyetje dëshmitarët.
20. Gjykata shkeli nenin 343 (1) të KPPK-së kur lejoi prokurorin të urdhërojë se për seancën e gjykatës dëshmitarët të cilët nuk u përgjigjen në ftesa i detyrohen gjykatës. Kjo shkel barazinë e palëve.

Ligji material

21. Cilësimi juridik i veprimeve të **F.G.** është i gabuar. Ai nuk mund të shpallet fajtor për krime të luftës sepse nuk ka pasur konflikt të armatosur në kohën kur është kryer krimi.

Gjendja faktike

22. Gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë korrekte. Ankuesi është i mendimit se fajësia e **F.G.** nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Një numër i provave të propozuara nga mbrojtja nuk është pranuar nga trupi gjykues por propozimet e tilla në fakt vetëm janë injoruar. Bazuar vetëm në rrethana fajësuese, konkluzioni i gjykatës lidhur me gjendjen faktike është i gabuar dhe i njëanshëm në kundërshtim me nenin 7 (1) të KPPK - së.
23. Trupi gjykues nuk ka vërtetuar në mënyrë korrekte kohën e krimit. Po që se këto prova të paraqitur do të ishin vlerësuar në mënyrë korrekte, konkluzioni i trupit gjykues lidhur me kohën e vrasjes së S.G. do të ishte i pamundshëm sepse ka deklarata kundërshtuese rreth fakteve vendimtare në këtë aspekt. Bazuar në deklaratat e N.B., krimi nuk ka mundur të ndodhë në periudhën kohore 21.00-21.40 sikurse është vërtetuar nga gjykata sepse të pandehurit nuk kanë mundur të arrijnë në vendin e krimit në atë kohë.
24. Nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se vepra penale është kryer nga **F.G.** (dhe N.B.), sepse kriminelët kanë vepruar në errësirë, çdo gjë ka ndodhur shumë shpejt, deklaratimet e ngjarjeve nën shqyrtim nga dëshmitarët e ndryshëm dallojnë në detaje të rëndësishme dhe **F.G.** nuk ngjante me dukjet e tij në kryerësin sikurse është përshkruar nga dëshmitarët.
25. Deklaratat e N.B. rreth asaj se si është kryer vrasja e S.G. janë vet-kundërthënëse e edhe në kundërshtim me provat e tjera. Në faza të ndryshme të procedurës, B. ka përshkruar në mënyrë të ndryshme detajet vendimtare rreth krimit (mënyra se si është kërkuar nga S.G. të tregojë rrugën në shtëpinë e viktimës; si ka ndodhur vrasja saktësisht – a ka pasur ndonjë komunikim në mes tyre dhe viktimës; kur dhe në çfarë rrethana ai u takua me **F.G.** në qershor 1999; ekziston një kontradiktë në mes të dëshmitarëve rreth asaj se cili ishte burimi i dritës në vendin e vrasjes, si ndodhi që asnjë anëtar i familjes së viktimës nuk ndërhyri; deklarata e drejtimit të ikjes së tyre është në kundërshtim me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë; ku kanë shkuar N.B. dhe **F.G.** pas gjoja kryerjes së vrasjes etj.). Trupi gjykues vet e ka pranuar dëshmitarin bashkëpunues N.B. burim kryesor të provave, të jetë kriminel me karakter pompoz që madje u përpoq t'i bënte shantazh **F.G.** me informacionet e paraqitur tani si prova kundër këtij të pandehuri. Ai është në vënë në dyshim nga fakti se kishte borxhe të mëdha dhe probleme financiare për shkak të stilit të jetës së tij. Fakti se N.B. e akuzon edhe veten për krimin në fjalë nuk e bën atë assesi më shumë të besueshëm sepse ai e bën këtë me shpresën për të kërkuar publicitet. Në kuadër të kësaj, ai është plotësisht burim jo i besueshëm nga këndvështrimi i ankuesit.
26. Ankuesi po ashtu ka vënë në pah se **F.G.** ka një alibi – ai po festonte fundin e konfliktit me Serbinë me disa persona të tjerë dhe ai madje ka edhe fotografi për ta provuar këtë.

27. **F.G.** nuk kishte motiv për të vrarë **S.G.**, sepse ai nuk e njihte viktimën. Në të vërtetë as trupi gjykues nuk e ka shpjeguar motivin e vrasjes. Duhet të theksohet se pa e vërtetuar motivin, askush nuk mund të shpallet fajtor për vrasje.

Dënimi

28. Kur ka dënuar **F.G.**, trupi gjykues ka zbatuar gabimisht ligjin material, sepse nuk është zbatuar ligji më i favorshëm.
29. Nuk i është kushtuar vëmendje e duhur gjendjes familjare, shëndetit dhe rrethanave të cilat përshkruajnë personalitetin e pa prishur dhe karakterin e mirë të **F.G.** kur është shqiptuar dënimi ndaj tij. Gjykata gabimisht ka vlerësuar faktin se në 12 vjetet të cilat kanë kaluar nga ndodhja e krimit, **F.G.** nuk kishte pasur asnjë çështje ligjore. Ky është dashur të vlerësohet si argument i fuqishëm lehtësues.

Mendimi i prokurorit të apelit të shtetit

30. Prokurori i apelit i shtetit i ka propozuar Gjykatës së Apelit që të refuzojë ankesën si të pabazuar dhe të vërtetë aktgjykimin e kundërshtuar të gjykatës së shkallës së parë. Prokurori konsideron se argumentet e ankuesit janë të pabazuara.
31. Shkeljet e shumta të ligjit procedural të pohuara nga avokati mbrojtës në fakt nuk kanë ndodhur. Edhe pse ka pasur vonesë në dorëzimin e aktgjykimit të arsyetuar tek palët, kjo nuk ka pasur ndikim në ligjshmërinë e aktgjykimit e as në të drejtat e të akuzuarit. Nuk ekziston asnjë kontradiktë në dispozitivin ose në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar. Asnjëra nga provat e pranueshme nuk ka qenë e papranueshme dhe të gjitha provat e pranueshme janë vlerësuar në mënyrë korrekte nga trupi gjykues. Prokurori nuk pajtohet me ankuesin se trupi gjykues do ta kishte lënë ndonjë nga kërkesat e mbrojtjes lidhur me provat pa u vënë re ose do të kishte refuzuar ndonjë kërkesë pa arsyetim të duhur. Shqyrtimi gjyqësor është zhvilluar saktësisht sipas normave procedurale në fuqi. Pohimi se **F.G.** do të ishte dënuar vetëm duke u bazuar në deklaratatë të pavërtetuara të dëshmitarit bashkëpunues **N.B.**, nuk është i drejtë. Prokurori po ashtu kundërshton pohimin se shfrytëzimi i deklaratave të dhëna nga **N.B.** në cilësinë e të pandehurit është e ndaluar. Pohimet lidhur me shkeljen e parimit të barazisë së armëve ose të drejtës për të qenë i pranishëm në seancën e gjykatës, janë po ashtu jo meritore. Janë të pabazuar insinuatat se do të ishte shfrytëzuar presion i kundërligjshëm kundër bashkë të pandehurit **H.R.** Pohimet se trupi gjykues lejoi prokurorin që të shkel rregullat e marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë trupi gjykues janë të gabuara. Në përgjigje të pohimit të mbrojtjes se prokurori bëri hetime të kundërligjshme madje edhe pas konfirmimit të aktakuzës, prokurori ka vënë re se asgjë në kodin procedural

nuk e ndalon prokurorin për të intervistuar dëshmitarët e propozuar nga mbrojtja. Prokurori nuk ka vërejtur asnjë shkelje të normave procedurale në faktin se gjykata lejoi prokurorin që të detyrojë dëshmitarët të paraqiten në gjykatë. Kjo ishte bërë thjesht për shkak të marrjes parasysh të ekonomisë procedurale.

32. Prokurori nuk pajtohet me pohimin e ankuesit se normat e ligjit humanitar kanë pushuar të zbatohen në Kosovë në kohën e vrasjes së S.G., sepse konflikti i armatosur kishte përfunduar në atë kohë.
33. Prokurori konsideron se vlerësimi i rrethanave në emër të trupit gjykues është i kompletuar dhe i qëndrueshëm. Çështja e besueshmërisë së dëshmitarit bashkëpunues ka qenë e vlerësuar me përpikëri të lartë nga trupi gjykues. Mospërputhshmëria e pohuar në mes të pjesëve të provave në realitet nuk është e pranishme, por të gjitha janë eliminuar. Prokurori ka vënë pah se pohimi i mbrojtjes se prokurori nuk e ka treguar motivin e krimit është i pabazuar. Motivi i krimit dhe lidhshmëria në mes të sjelljes kriminale dhe konfliktit të armatosur është shoshitur në mënyrë të plotë në aktgjykim.
34. Prokurori nuk pajtohet me kritikën në emër të ankuesit lidhur me dënimin e të pandehurit. Trupi gjykues në mënyrë korrekte ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese edhe lehtësues në lëndë. Rrethanat e përmendura në ankesë nuk mund të zbusin barbarin e krimit për të cilin personi i dënuar akuzohet.

III. Kompetenca e Gjykatës së Apelit

35. Gjkata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur mbi ankesat sipas neneve 17 dhe 18 të Ligjit mbi gjykatat.
36. Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhshmëri me nenin 19(1) të Ligjit mbi gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhja e lëndëve dhe caktimi i lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053).

IV. Ligji procedural i zbatueshëm – KPPK

37. Gjkata e Apelit e konsideron të duhur të ritheksoj se ligji procedural i aplikueshëm në lëndën penale përkatëse është Kodi i vjetër i procedurës penale të Kosovës i cili ishte në fuqi deri më datën 31 dhjetor 2012.¹ Në procedurat penale të iniciuara para hyrjes në fuqi të Kodit të ri të procedurës penale për të cilat gjykimi tanimë kishte filluar por nuk kishte përfunduar

¹ Kodi i procedurës penale të Kosovës, në fuqi prej datës 6 prill 2004 deri më 31 dhjetor 2012.

me vendim të formës së prerë, vlejnë dispozitat e KPPK-së derisa vendimi të marrë formën e prerë. Është referuar në dispozitat aktuale kalimtare të Kodit të procedurës penale dhe në Mendimin juridik nr. 56/2013 të Gjykatës Supreme të Kosovës, i miratuar në seancën e saj të përgjithshme më datën 23 janar 2013.

V. Ligji penal material i zbatueshëm

38. Shpallja fajtor dhe dënimi i të akuzuarit për krime lufte është i bazuar në dispozitat e Kodit penal të RSFJ si ligj i zbatueshëm në kohën kur ishte kryer vepra penale.²
39. Kolegji vëren se që nga kryerja e veprës penale të pohuar, Ligji penal i Kosovës është ndryshuar dy herë. Më 6 prill 2004 ka hyrë në fuqi Kodi i përkohshëm penal i Kosovës dhe i njëjti ka mbetur në fuqi deri më 31 dhjetor 2012. Më 1 janar 2013 ka hyrë në fuqi Kodi i ri penal i Kosovës, Kodi nr. 04/L-082 (tash e tutje në tekst: KPRK) dhe aktualisht është ligj penal i zbatueshëm.
40. Sipas parimit të përgjithshëm të zbatimit të ligjit më të favorshëm për të akuzuarin, i paraparë me nenin 2(2) të KPK-së dhe nenin 3(2) të KPRK-së, në rast të ndryshimit të ligjit të aplikueshëm në lëndën përkatëse para vendimit të formës së prerë, vlen ligji më i favorshëm për të pandehurin.
41. Gjykata e Apelit *ex officio* analizoi dispozitat e zbatueshme të tri ligjeve penale për të vërtetuar nëse njëri nga dy ligjet e miratuara në vazhdimësi është më i favorshëm për të akuzuarin se sa ai në të cilën trupi gjykues është mbështetur. Gjykata konsideron se asnjëri nga ligjet pasuese nuk është më i favorshëm, prandaj vlejnë dispozitat në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

VI. Pranueshmëria e ankesave

42. Aktgjykimi i kundërshtuar i është dorëzuar avokatit mbrojtës T.R. më datën 8 maj 2012 ndërsa të pandehurit më 15 maj 2012.

² Sipas rregullores së UNMIK-ut 1999/24, e ndryshuar me rregulloren e UNMIK-ut 2000/59, dispozitat e ligjit material penal në fuqi ishin dispozitat e Kodit penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, me amendamentet e shpallura me rregulloret e lartë përmendura të UNMIK-ut. Dënimi me vdekje u hoq sipas nenit 1.5. Në pajtueshmëri me nenin 1.6 të rregullores së UNMIK-it 2000/59 për secilën vepër të dënueshme me dënim me vdekje sipas ligjit në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, dënimi me vdekje u shndërrua në dënim me burgim në mes të minimumit të paraparë me ligj për atë vepër dhe maksimumi prej dyzet (40) vjetësh.

43. Ankesa është parashtruar pranë Gjykatës së Qarkut të Prishtinës më datën 16 maj 2012.
44. Nga lart shihet se ankesa është parashtruar brenda afatit kohor. Kolegji po ashtu vëren se ankesa është parashtruar nga personi i autorizuar dhe prandaj është e pranueshme në bazë të neneve 399 dhe 401 të KPPK-së.

VII. Gjetjet lidhur me bazat e ankesave

Shkeljet e normave të procedurës penale

45. Gjykata e Apelit nuk pajtohet me palën parashtruese se ka pasur shkelje të tilla serioze të normave të procedurës penale në lëndën në fjalë, të cilat do të sillnin tek anulimi i aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut dhe tek kthimi prapa i lëndës në fjalë për rigjykim. Duke iu përgjigjur kritikave konkrete të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljet procedurale duhet të ceket si në vazhdim.
46. Vonesa në dërgimin e aktgjykimit të arsyetuar tek palët pa dyshim se bie në kundërshtim me këtë të fundit dhe me frymën e KPPK-së, për arsye se çfarëdo vonese në nxjerrjen e aktgjykimit ka ndikim në të drejtat themelore të të pandehurit. Megjithëkëtë, një vonesë e tillë mund të jetë arsye vetëm për prishjen e aktgjykimit, në qoftë se ka kontribuar në aspektin e kundërligjshmërisë së aktgjykimit. Asgjë në këtë drejtim nuk është kundërshtuar nga ana e parashtruesit të ankesës. Për më tepër, duhet të konstatohet se me letrën e datës 23 nëntor 2011, kryetari i trupit gjykues e ka informuar kryetarin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës se aktgjykimi nuk do të ishte hartuar brenda afatit kohor të përcaktuar me nenin 395 të KPPK-së, për shkak të ndjeshmërisë së lëndës dhe sasisë së provave të cilat është dashur të vlerësoheshin. Gjykata e Apelit po ashtu pajtohet me referimin që e kishte bërë në përgjigjen e vet prokurori i apelit i shtetit. Zaten, paraburgimi i personit të dënuar është zgjatur deri sa aktgjykimi të marrë formë të prerë përmes një aktvendimi të posaçëm të datës 23 nëntor 2011. Mbrojtësi kishte pasur mundësinë e parashtrimit të ankesës ndaj këtij aktvendimi apo kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, porse një ankesë apo kërkesë e tillë nuk ishte parashtruar nga ana e mbrojtësit. Kolegji për ankesa nuk e vlerëson vonesën e dorëzimit të aktgjykimit të arsyetuar të ketë asi natyre në rastin konkret sa të kishte shkaktuar ndikim joproporcional në të drejtat themelore të të pandehurit në fjalë.
47. Pohimet e ankuesit lidhur me kundërshtitë në dispozitivin apo në arsyetimin e aktgjykimit të kontestuar janë të pambështetura. Kolegji ia përkujton mbrojtësit se mund t'iu referohet këtyre kundërshtive vetëm nëse ka mospërputhje esenciale në pjesët përkatëse të aktgjykimit apo në mes të arsyetimit dhe dispozitivit, *d.m.th.* në rast se konkluzionet e gjykatës nuk mund të bazohen në mënyrë të logjikshme në faktet themelore. Në lëndën në fjalë nuk mund të gjendet asnjë gjë si kjo. Vetë fakti se një palë nuk pajtohet me qëndrimet e gjykatës nuk

mund të shërbejë si arsye për dhënien e kritikave që kanë të bëjnë me paqartësinë dhe kundërshtimet e brendshme të aktgjykimit në fjalë. Dispozitivi i aktgjykimit të kontestuar përmban të gjitha elementet e përcaktuara me ligj dhe është në përputhje të plotë me arsyetimin e gjykatës.

48. Mbrojtësi pohon se aktgjykimit të kontestuar i mungon arsyetimi lidhur me faktet vendimtare si dhe arsyetimi ekzistues është i paqartë dhe në kundërshtim me veten. Ai thekson se trupi gjykues ka gabuar kur nuk ka dëgjuar shumë dëshmitarë të propozuar nga mbrojtja dhe nuk ka administruar provat materiale, duke injoruar thjesht kërkesat e mbrojtjes në këtë drejtim. Ankuesi e thekson se trupi gjykues nuk e ka marrë parasysh fjalën e tij përfundimtare në të cilën është rrëzuar çdo pohim i prezantuar në aktakuzë. Gjykata e shkallës së parë nuk e ka bërë vlerësimin e drejtë të provave kundërshtuese.
49. Gjykata e Apelit nuk pajtohet me pohimin se trupi gjykues gabimisht nuk ka vlerësuar apo bile edhe ka pranuar shumë prova të propozuara nga avokati mbrojtës. Palët kanë mundur të paraqesin provat dhe t'i propozojnë gjykatës marrjen e provave të reja. Sa herë që është parashtruar një propozim i tillë, gjykata iu ka lejuar palëve t'i shpjegojnë arsyet për kërkesën dhe rëndësinë e provës së propozuar lidhur me akuzat. Më 5 gusht 2011 dhe më 7 shtator 2011, gjykata i ka nxjerrë aktvendimet duke vendosur rreth propozimeve të mbrojtësit për të dëgjuar disa dëshmitarë. Në shqyrtimin e datës 7 qershor 2011, disa prej provave i janë kthyer avokatit mbrojtës si të papranueshme. Në shqyrtimin e 21 tetorit 2011, me kërkesë të mbrojtësit, kryetari i trupit gjykues ka deklaruar se “të gjitha provat ato që janë pranuar janë diskutuar dhe të gjitha ato të cilat nuk janë diskutuar në mënyrë eksplicite nuk janë pranuar dhe materiali është kthyer”. Gjykata e Apelit është e mendimit se të dyja palët janë trajtuar në mënyrë të barabartë nga trupi gjykues dhe janë respektuar normat me të cilat rregullohet çështja e provave.
50. Nuk mund të pajtohet as pohimi se gjoja Gjykata e Apelit do t'i kishte lënë të pavlerësuar kundërshtitë në mes të provave të ndryshme. Gjykata e Qarkut ka bërë vlerësimin e secilës dëshmi të dëshmitarëve dhe ka dhënë arsyetimin gjithëpërfshirës lidhur me atë se pse i ka dhënë apo nuk i ka dhënë peshë dëshmive të tilla dhe provave të tjera të prezantuara nga palët. Në qoftë se një palë vendos të mos pajtohet me epilogun e një vlerësimi të tillë të gjykatës, kjo gjë nuk e bën vlerësimin të pavlefshëm.
51. Lidhur me pretendimin se trupi gjykues në kundërshtim me nenin 371 (1) të KPPK-së, ka dëgjuar të pandehurin para dëshmitarit të mbrojtjes **B.D.**, duhet të theksohet se marrja në pyetje e dëshmitarit në fjalë është kërkuar nga ankuesi në shqyrtimin e datës 17 tetor 2011. Në të njëjtin shqyrtim, avokati mbrojtës është pajtuar me propozimin e kryetarit të trupit gjykues për ta marrë në pyetje të pandehurin para dëshmitarit. Prandaj argumenti në fjalë i parashtruar në ankesë nuk qëndron.

52. Shkelja e nenit 371 (3) të KPPK-së, së cilës i referohet ankuesi, nuk është aq e rëndë saqë të sjellë gjer tek anulimi i aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut. Nuk ka arsye për të besuar se kjo shkelje ka pasur ndikim apo ka mundur të ketë ndikim në nxjerrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të rregullt, duke pasur parasysh se H.R. ka qëndruar pranë deklaratave të tija të mëhershme dhe ka refuzuar të merret në pyetje në gjykim.
53. Argumenti i ankuesit se gjoja deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues N.B. nuk janë vërtetuar me asnjë provë tjetër dhe prandaj duke shkelur nenin 157 (4) të KPPK-së kanë shërbyer si bazë e vetme për dënimin e **F.G.**, janë të pabaza. Deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues janë vërtetuar me deklarata të dëshmitarëve të tjerë (anëtarët e familjes së viktimës). Këta dëshmitarë kanë dëshmuar për modalitetet e futjes së kryerësve brenda në shtëpinë e viktimës, dukjen fizike të kryerësve, errësirën në dhomë për shkak të mungesës së rrymës elektrike, sjelljen e kryerësve, armët e tyre, dhe zhvillimin e veprimit kriminal si dhe ikjen e ngutshme të tyre nga shtëpia. Shikuar në tërësi, materiali provues në dispozicion të gjykatës është i mjaftueshëm për vërtetimin e fajësisë së **F.G.** përtej dyshimit të arsyeshëm.
54. Avokati mbrojtës pohon se gjykata e shkallës së parë ka lejuar prokurorin duke shkelur nenin 153 (2) dhe 154 (4) të KPPK-së, që t'iu referohet dëshmive të dhëna nga N.B. gjatë hetimeve në cilësinë e të pandehurit. Këto prova janë të papranueshme, sepse në cilësinë e të pandehurit N.B. nuk ka qenë i obliguar ta thotë të vërtetën, përderisa gjatë gjykimit i njëjti është intervistuar në cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues dhe prandaj ka qenë i obliguar ta thotë të vërtetën. Kështu, prokurori është dashur ta intervistojë edhe një herë N. Bllacën për të gjitha rrethanat e veprës penale, pasi i njëjti është shpallur dëshmitar bashkëpunues. Argumentimi i ankuesit është jomeritor, ngase me KPPK nuk përcaktohet diçka e tillë. Deklarata e marrë në përputhje me statusin procedural të personit nuk bëhet provë e papranueshme vetëm për shkak se statusi më vonë ka ndryshuar. N.B. gjithmonë është intervistuar në përputhje me statusin të cilin e ka pasur kur është mbajtur intervista: së pari si i dyshuar, pastaj si i pandehur dhe në fund si dëshmitar bashkëpunues. Rregullat e procedurës të cilat janë ndjekur kanë qenë në përputhje me dispozitat e KPPK-së (dhe tash të KPP-së). Po ashtu, duke e pranuar në mënyrë indirekte se statusi i mëhershëm i dëshmitarit bashkëpunues ka qenë status i të dyshuarit dhe i të pandehurit dhe jo status i dëshmitarit, kodi e përmbush vakumin e përfaqësuar nga mungesa e obligimit të vërtetësisë ndaj të pandehurit duke e zbatuar këtë obligim mbi dëshmitarin bashkëpunues para dhënies së dëshmisë nën urdhrin për mbrojtje.
55. Gjykata e Apelit nuk pajtohet me pohimin e mbrojtjes se as avokati mbrojtës as i pandehuri nuk kanë marrë kopjen e urdhrin me të cilin N.B. është shpallur dëshmitar bashkëpunues. Ky urdher u është dorëzuar atyre në seancën e konfirmimit të aktakuzës të mbajtur më 25 nëntor 2010. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij nuk kanë qenë në mënyrë efektive të privuar nga e

drejta për ta sfiduar këtë urdhër, për shkak se sipas KPPK-së një urdhër i tillë është i formës së prerë dhe nuk mund të ankimohet.

56. Ankuesi pohon shkelje të nenit 313 (2) të KPPK-së, për shkak se në seancën e konfirmimit të aktakuzës të mbajtur më 21 dhjetor 2010, kur është shpallur aktvendimi mbi konfirmimin e aktakuzës, palët “të cilat duhet domosdo të prezantojnë në seancën e konfirmimit të aktakuzës nuk kanë qenë të pranishme dhe nuk kanë qenë të njoftuara rreth seancës në fjalë.” Gjykata e Apelit vëren se seanca për konfirmimin e aktakuzës është mbajtur më 25 nëntor 2010. Duke u bazuar në procesverbalin e shqyrtimit del se avokatët mbrojtës të **F.G.** kanë pohuar se prokurori nuk i kishte përmbushur detyrat e veta për transparencë sepse disa prej dokumenteve nuk u ishin dërguar të pandehurit dhe mbrojtësit, dhe kishte kërkuar shtyrjen e tij. Procesverbali i shqyrtimit pasqyron dërgimin e dokumenteve që mungojnë tek avokatët mbrojtës të **F.G.** dhe se gjithashtu shqyrtimi konfirmues kishte përfunduar të njëjtën ditë. Më 1 dhjetor 2010, avokati mbrojtës **F.G.** kishte dorëzuar deklaratën me shkrim dhe më 21 dhjetor 2010, gjyqtari konfirmues kishte nxjerrë aktvendimin K.A. Nr. 339 / 2010 duke e konfirmuar aktakuzën ndaj **F.G.** dhe H.R. Në mungesë të një procesverbali me shkrim, duhet të konstatohet se nuk ishte mbajtur asnjë shqyrtim më datën 21 dhjetor 2010. Palët ishin njoftuar përmes aktvendimit me shkrim të gjyqtarit konfirmues, me të cilin palët ishin udhëzuar për të drejtën e tyre për t’u ankuar. Avokati mbrojtës nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë në kohën e duhur; prandaj një pohim i tillë është vjetruar tashmë në këtë instancë, duke e bërë kështu pohimin në fjalë jomeritor.
57. Pohimet lidhur me shtrëngimin e kundërligjshëm ndaj të bashkëpandehurit H.R. nuk janë shpifje të pambështetura dhe nuk meritojnë asnjë koment më të detajuar nga ana e Gjykatës së Apelit.
58. Mbrojtësi pohon se trupi gjykues ka shkelur rregullat e procedurës penale duke ia lejuar prokurorit parashtrimin e pyetjeve sugjestive dhe orientuese ndaj dëshmitarit bashkëpunues N.B. dhe dëshmitarëve të tjerë të prokurorisë; duke iu bërë të njëjtat pyetje disa herë me radhë derisa të merrte prej tyre përgjigjen e dëshiruar; dhe duke e sjellë dëshmitarin bashkëpunues N.B. dy herë në gjykatore me qëllim të korigjimit të deklaratave të tija të mëparshme. Po ashtu, prokurori pretendohet se vazhdimisht i kishte ndërprerë avokatët mbrojtës me qëllim të hutimit të tyre dhe pamundësimin të ushtrimit të mbrojtjes së duhur.
59. Ankuesi po ashtu e thekson se gjatë shqyrtimit gjyqësor, dëshmitari bashkëpunues N.B. ishte thirrur edhe një herë nga prokurori për të dëshmuar dhe me atë rast ai e kishte korigjuar përmbajtjen e deklaratave të tija të mëparshme duke e vërtetuar se atë që e kishte shkruar në letrën të cilën e kishte lënë nën murin e shtëpisë së A.G. nuk kishte qenë e tëra plotësisht e vërtetë. Ai e kishte korigjuar versionin e tij të fakteve me qëllim të përshtatjes me përmbajtjen e deklaratave të dhëna nga dëshmitarët e tjerë.

60. Në përgjigje ndaj kritikave të përmendura më lart, Gjykata e Apelit është e mendimit se pohimi se sikur trupi gjykues të kishte lejuar prokurorin të parashtronte pyetje orientuese dhe sugjестive apo t'i përsëriste pyetjet derisa të merrte "përgjigjen e duhur", nuk mbështetet me procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor prandaj është jomeritor. Kolegji i apelit konstaton se në përputhje me pohimin e prokurorit të apelit se vazhdimësia e ndërprerjeve dhe e hutimit të avokatit mbrojtës nga ana e prokurorit në fakt nuk ka ndodhur fare. Kur kërkesa e prokurorit për ta thirrur prapë N.B. për të dëshmuar ishte miratuar nga trupi gjykues, mbrojtja nuk kishte kundërshtuar një gjë të tillë. Thirrja për herë të dytë e dëshmitarit bashkëpunues ka qenë e domosdoshme me qëllim të sqarimit të disa çështjeve të cilat kanë ndodhur gjatë shumë seancave të gjykimit, në frymën e statusit të posaçëm dhe detyrimeve përkatëse të N.B. si dëshmitar bashkëpunues si dhe kufizimi i caktuar me nenin 157 (4) të KPPK-së. Me propozimin e prokurorit, trupi gjykues në seancën dëgjimore të datës 8 shtator 2011 kishte vendosur ta thërriste sërish N.B. për ta ballafaquar me deklaratat e dhëna nga dëshmitarët e tjerët si dhe me qëllim të sqarimit të disa pikave. Në seancën dëgjimore të datës 29 shtator 2011, dëshmitarit thjesht i është kërkuar të deklarohet nëse dëshmia e tij e datës 13 prill 2011 lidhur me vendin ku kishin fjetur vrasësit pas kryerjes së vrasjes kishte qenë e saktë apo jo. Çështja përkitazi me saktësinë e procesverbalit të gjykimit lidhur me pikën nëse N.B. kishte thënë a kishte qenë kjo shtëpia e A. apo jo. Kjo çështje, e cila tashmë ishte sqaruar në shqyrtimin e datës 13 prill 2011 përmes pyetjeve të avokatit mbrojtës, ka qenë po ashtu çështja kryesore gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit S.A., i cili është marrë në pyetje një kohë të shkurtër pas marrjes në pyetje të N.B. më datën 29 shtator 2011.
61. Ankuesi e konsideron se ka pasur një tjetër shkelje esenciale të procedurës penale duke u nisur nga fakti se trupi gjykues ia ka lejuar prokurorit të përdorë si prova deklaratat e disa prej dëshmitarëve të mbrojtjes të cilët ishin marrë në pyetje nga prokuroria në kohën kur po vazhdonte ende shqyrtimi gjyqësor. Edhe pse avokati mbrojtës kishte propozuar që deklaratat në fjalë të shpallehin të papranueshme, trupi gjykues madje nuk kishte marrë kurrfarë vendimi lidhur me këtë çështje. Avokati mbrojtës shpreh mendimin e vet se e drejta e prokurorit për të zhvilluar hetime pas ngritjes së aktakuzës duke marrë në pyetje dëshmitarët është e drejtë e kufizuar. Rezultatet e hetimeve të tilla mund të përdoren vetëm me qëllim të vlerësimit të nevojës së propozimit të një personi të caktuar për t'u thirrur si dëshmitar nga gjykata apo jo.
62. Gjykata e Apelit konstaton se nuk ka pasur shkelje të procedurës penale në ato që u thanë më lart dhe pajtohet në këtë drejtim me vlerësimin tashmë të dhënë nga ana e trupit gjykues në shqyrtimin e datës 22 qershor 2011 se pas konfirmimit të aktakuzës, prokurori ka intervistuar disa dëshmitarë të propozuar nga avokati mbrojtës e po ashtu edhe dëshmitarë të tjerë; se mbrojtësit i është dhënë një kopje e procesverbalit të këtyre intervistave; dhe se

asnjë dispozitë e KPPK-së nuk e ndalon hetimin e kryer pas ngritjes së aktakuzës apo që e parandalon prokurorin nga intervistimi i dëshmitarëve të propozuar nga mbrojtja.

63. Në fund, Gjykata e Apelit nuk pajtohet me pohimin e mbrojtjes se është shkelur neni 343 (1) i KPPK-së, sepse në seancën dëgjimore të datës 26 qershor 2011, gjykata ia ka lejuar prokurorit t'i detyrojë dëshmitarët që të paraqitet në gjykatë. Kjo çështje po ashtu tashmë është shpjeguar në mënyrë adekuate nga trupi gjykues, kur është trajtuar problemi i mosparaqitjes së dëshmitarëve të ftuar. Kërkesa e trupit gjykues që prokurori të intervenojë në këtë çështje ka qenë e domosdoshme nga fakti se përkundër planifikimit të shoqërimit të dëshmitarëve të ftuar, procedura në fjalë ishte ndërprerë për shkak të një keqkuptimi me policinë. Me qëllim të sigurimit të një gjykimi të sigurt dhe të shpejtë, duke qenë se prokurori është një instancë që punon me policinë nga i njëjti është kërkuar të ndihmojë me kontributin e tij, gjë e cila nuk bie në kundërshtim me ligjin.

Ligji material

64. Avokati mbrojtës nuk pajtohet me trupin gjykues lidhur me vlerësimin se më datën 15 qershor 1999 ende ka qenë duke vazhduar një konflikt i brendshëm i armatosur në mes të forcave të Republikës së Serbisë dhe të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, *d.m.th.* në kohën e veprës penale në fjalë. I njëjti pohon se konflikti i armatosur kishte përfunduar deri në atë datë dhe ligji humanitar kishte pushuar së zbatuari. Për këtë arsye, sipas mbrojtësit, sjellja e të pandehurit gabimisht është cilësuar si krim i luftës. Gjykata e Apelit konsideron se një mospajtim i tillë i ankuesit është i pambështetur me prova. Trupi gjykues ka dhënë dëshmi të përpiktë lidhur me secilin aspekt relevant të çështjes së vazhdimësisë së konfliktit të armatosur në Kosovë dhe lidhjen në mes të veprimit të akuzuarit dhe konfliktit. Analiza përkatëse e trupit gjykues është jashtëzakonisht bindëse dhe nuk lë asnjë fije dyshimi lidhur me vazhdimin e zbatimit të ligjit humanitar në Kosovë më datën 15 qershor 1999.

Vërtetimi i fakteve

65. Lidhur me orën dhe datën e kryerjes së vrasjes, ankuesi është i pikëpamjes se provat e shqyrtuara nga ana e trupit gjykues nuk e mbështesin versionin se vrasja e S.G. është kryer në orën e propozuar në aktakuzë.
66. Kolegji i apelit vëren se N.B. ka pranuar gjatë tërë procedurës se nuk i kujtohet saktësisht ora e kryerjes së krimit; madje edhe në letrën të cilën ia kishte shkruar A.G. në vitin 2007 ai i kishte thënë se nuk mund t'i kujtohej saktësisht data e vrasjes. Megjithatë, pavarësisht pasigurive të tilla, dëshmitari bashkëpunues ka ofruar një dëshmi të saktë dhe të besueshme rreth vrasjes së S.G., që nga përgatitja e saj e deri tek vetë akti i vrasjes, duke përfshirë këtu edhe hollësitë e rrugëtimit deri në shtëpinë e viktimës dhe përshkrimin e shtëpisë. Këto deklarata janë vërtetuar me provat e tjera dhe duke u bazuar në vlerësimin e tërësishëm të

provave, trupi gjykues ka arritur tek konstatimi i besueshëm se vrasja është kryer në periudhën në mes të orës 21:00 dhe 21:40 të datës 15 qershor 1999.

67. Ankuesi e kundërshton besueshmërinë e deklaratave të N.B., duke theksuar se deklaratat e tij kanë qenë kontradiktore gjatë fazave të ndryshme të procedurës; se personaliteti dhe raportet me të pandehurin i zhveshin deklaratat e tij nga çfarëdo besueshmërie. Avokati mbrojtës po ashtu sugjeron se ka kontradikta në deklaratat e dëshmitarëve të tjerë përkitazi me faktet vendimtare.
68. Gjykata e Apelit nuk pajtohet me kritikën e përmendura më sipër dhe është e mendimit se Gjykata e Qarkut i ka kushtuar vëmendje të duhur çështjeve të besueshmërisë si dhe kontradiktave të ndryshme të cilat janë paraqitur në deklaratat e ndryshme të dëshmitarëve gjatë tërë shqyrtimit të lëndës. Shpjegimi i ofruar nga ana e Gjykatës së Qarkut, lidhur me atë se pse deklaratat e N.B. janë të besueshme pavarësisht armiqësisë së tij evidente ndaj të pandehurit, përpjekjeve të tija të vërtetuara për ta shantazhuar dhe informatat lidhur me personalitetin e tij të pabesë, është shpjegim i hollësishëm, adekuat dhe imponues. Gjykata e Apelit nuk sheh ndonjë arsye për ta injoruar vlerësimin përkatës së trupit gjykues.
69. Ajo çfarë ka të bëjë me kontradiktat e sugjeruara në deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues dhe të dëshmitarëve të tjerë, Gjykata e Apelit vlerëson se asnjë prej këtyre kontradiktave nuk ka ndonjë cilësi të tillë saqë të dëmtojë besueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve përkatës në tërësi. Këto kontradikta në shumicën e rasteve kanë të bëjnë me detaje të vogla, përderisa në përshkrimin e përgjithshëm të ngjarjeve dhe rrethanave të veprës, përputhen të deklaratat e dëshmitarëve. Aktgjykimi i kontestuar e jep një pasqyrë të plotë të këtyre mospërputhjeve dhe i konsideron të njëjtat logjikisht të shpjegueshme me kohën e gjatë e cila ka kaluar që nga ngjarjet në fjalë. Po ashtu duhet të përmendet se deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues N.B. dhe të anëtarëve të familjes së viktimës përputhen në shumicën e detajeve të ngjarjes të cilën po e diskutojmë.
70. Duhet të nënvizohet se madje edhe vetë ankuesi nuk e ofron asnjë argument konkret me të cilin tregohet se gjetjet e gjykatës janë të pasakta dhe e kufizon veten vetëm në mënyrë spekulative duke pohuar se gjetjet e tilla janë të gabueshme. Gjykata e Apelit e sheh të udhës t'ia përkujtojë avokatit mbrojtës se në rend të parë është në kompetencën e trupit gjykues për ta bërë vlerësimin e rrethanave të lëndës. Gjykata e Apelit mund të ndërhyjë me pushtetin e vet diskret vetëm në rast se Gjykata e Apelit e gjen se gjykata e shkallës së parë i ka shkelur rregullat e një vlerësimi të tillë. Megjithatë, në rastin në fjalë nuk konstatohet diçka e ngjashme.
71. Për këtë arsye, Gjykata e Apelit është e bindur se Gjykata e Qarkut e ka konstatuar fajësinë e **F.G.** përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

72. Lidhur me kritikën e mbrojtjes së dënimit të **F.G.** ka qenë i kundërligjshëm, për shkak se trupi gjykyes nuk ka treguar se çfarë ka qenë motivi i një akti të tillë, Gjykata e Apelit e thekson se motivi nuk është element përbërës i veprës penale të vrasjes. Për këtë arsye, mungesa e vlerësimit të motivit nga arsyetimi i aktgjykimit nuk përfaqëson kurrfarë shkelje të vërtetimit të gjendjes faktike apo të zbatimit të ligjit penal material. Megjithatë, duhet po ashtu të theksohet se në rastin në fjalë, Gjykata e Qarkut në fakt e ka konstatuar motivin për të cilin është kryer vrasja e viktimës në fjalë. Duhet të tërhiqet vëmendja në këtë aspekt tek par. 116 i aktgjykimit të kontestuar, sipas të cilit Gjykata e Qarkut konstaton – duke u bazuar në deklaratën e dëshmitarit bashkëpunues N.B. – se S.G. është vrarë për shkak të gjoja bashkëpunimit të tij me Serbinë.

Dënimi

73. Ankuesi pretendon se Gjykata e Qarkut nuk u ka dhënë peshën e duhur rrethanave rënduese dhe lehtësuese, duke i nënvlerësuar këto të fundit dhe duke e mbivlerësuar peshën e rrethanave rënduese. Gjykata nuk e ka vlerësuar drejt faktin se tashmë ka kaluar një kohë e gjatë që nga kryerja e krimit, faktin se i pandehuri i ka dy gra dhe gjashtë fëmijë, sjelljen e tij dhe shpirtin human, dhe faktin se i pandehuri është shëndetlig.

74. Asnjë prej argumenteve në fjalë nuk është i vlefshëm në mendimin e Gjykatës së Apelit. Duhet të përkujtojmë se po ashtu vlerësimi i rrethanave me të cilat përcaktohet shkalla e saktë e dënimit është në zgjedhjen e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykata e Apelit është kompetente vetëm për ta hedhur poshtë një vlerësim të tillë po qe se rrethanat konkrete tregojnë shkeljen e kufijve të zgjedhjes së Gjykatës së Qarkut. Asgjë në atë drejtim nuk është theksuar në ankesa. Pohimet se Gjykata e Qarkut nuk i ka dhënë peshën e duhur rrethanave të cilat kanë të bëjnë me dënimin janë plotësisht të pambështetura.

75. Megjithatë, Gjykata e Apelit e vëren se dënimi i **F.G.** duhet të zbutet për shkak të zbatimit të gabueshëm të ligjit material. I pandehuri **F.G.** duhet të shpallet fajtor për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullsisë civile në bazë të nenit 142 dhe 22 të KP të RSFJ-së (nenet 120 dhe 23 të KPK-së). Pasi që ligji penal material në raport me dënimet në dispozicion ka ndryshuar dukshëm nga koha e kryerjes së veprës penale deri në kohën e dënimit të të pandehurit në fjalë, dënimi në fjalë është dashur të vendoset në bazë të ligjit më të favorshëm për të akuzuarin. Në bazë të vlerësimit të Gjykatës së Qarkut të neneve 38 dhe 142 të KP të RSFJ-së, përcaktohet dënimi me burgim prej jo më pak se pesë vjet apo dënimi me vdekje për veprën penale të kryer nga **F.G.**, kombinimi i këtyre dy neneve do të ishte ligji më i favorshëm për të akuzuarin në fjalë. Gjykata e Qarkut me të drejtë ka konstatuar se dënimi kapital është shfuqizuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, përderisa në bazë të nenit 38 të KP të RSFJ-së, dënimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër sesa 15 ditë

dhe nuk mund të jetë më i gjatë sesa 15 vjet. Në fjalinë e dytë të këtij neni, megjithatë, parashihet që në raste të jashtëzakonshme, në rast të veprave penale të dënueshme me dënimin me vdekje, dënimi maksimal me burgim të jetë 20 vjet. Gjykata e Apelit nuk pajtohet me këtë konstatim, duke e gjetur se një konstatim i këtillë vjen si rezultat i interpretimit të gjerë të gabueshëm të ligjit penal material në dëm të të akuzuarit. Gjykata e Apelit, në mungesë të legjislacionit të qartë në këtë drejtim, është e mendimit se në situatën kur dënimi me vdekje është shfuqizuar nga ana e UNMIK-ut, më nuk mund t'i referohemi fjalisë së dytë të nenit 38 të KP të RSFJ-së dhe se dënimi maksimal me burgim në dispozicion mund të përcaktohet duke u bazuar vetëm në fjalinë e parë të nenit 38 të KP të RSFJ-së si dhe në nenin përkatës të pjesës së posaçme që përcakton veprën penale për të cilën është dënuar i pandehuri. Kjo pikëpamje po ashtu përputhet me praktikën e gjykatave në Kosovë.³

76. Nga sa u tha më lart, është e qartë se dënimi për **F.G.** duhet të jetë në mes të 5 dhe 15 vjet burgim. Duke u bazuar në vlerësimin e drejtë të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të prezantuara në aktgjykimin e kontestuar, Gjykata e Apelit e konsideron të drejtë dënimin e **F.G.** me 14 vjet burgim.

Përfundim

77. Për këtë arsye vendoset si në dispozitiv.

Përgatitur në gjuhën angleze, si gjuhë të autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar është përfunduar më datën 1 prill 2014.

Kryetarja e kolegjit

Annemarie Meister
Gjyqtare e EULEX-it

³ Shih aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në lëndën L.G. *et alia* – Nr. AP-KZ 139/2004 të datës 21 korrik 2005, por po ashtu edhe aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në lëndën S.A. *et alia* - Nr. P 592/11 të datës 17 dhjetor 2012 (të vërtetuar nga Gjykata e Apelit në pjesën e vlerësimit të ligjit më të favorshëm për qëllimin e dënimit – aktgjykimin NR. PaKr 102/13 të datës 12 dhjetor 2013).

Anëtari i kolegjit

Philip Kanning
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtari i kolegjit

Driton Muharremi
Gjyqtar kosovar i Gj/A-së

Procesmbajtës

Andres Parmas
Zyrtar ligjor i EULEX-it

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Pakr 1175/12

10 shkurt 2014